



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:038252
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05624187

Ac.nr.3632/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit Bujar Muzaqi dhe Liridon Maloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. Gj. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Y. B., avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Vjollca Shyti, për kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.178/2022, të datës 27.02.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditëses M. Gj. nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.178/2022, të datës 27.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.178/2022, të datës 27.02.2023, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M. Gj. nga Gjakova, përmes së cilës ka kërkuar që të “*detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses të lartcekur, për periudhën kohore nga 01.01.2015 e deri me datë 17.04.2017, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit të ia paguajë shumën prej 992.00.-€ (nëntëqind e nëntëdhjetë e dy euro), si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 694.40.-€ (gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër euro e dyzet cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale*”. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe shpenzimeve të procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se e paditura të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja M. Gj., përmes të autorizuarit të saj, me datë 24.02.2022, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, kundër të paditurës, me pretendimet se e njëjta është e punësuar tek e paditura dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë së bashku me shpenzimet për udhëtimin (më detajisht si në petitumin e padisë si në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.178/22, të datës 27.02.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “ nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, për gjykatën nuk është kontestuese se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën fillore “Sh. K.” në fshatin N. e E., Komuna e Gjakovës, si mësimdhënëse dhe bazuar në Vërtetimin me numër 35/2022 i datës 09.02.2022 të lëshuar nga e paditura, rezulton se paditësja nga data 01.01.2015 deri me datë 17.04.2017 ka punuar gjithsej 496 ditë pune dhe në këto ditë pune ka udhëtuar nga vendbanimi i saj për në vendin e punës duke paguar biletën e udhëtimit në vlerë prej 1.00 euro, një drejtim, sipas Vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve për relacionin Gjakovë – N. e E., pasi që e njëjta banon në Gjakovë, fakt i vërtetuar përmes Certifikatës së vendbanimit me numër serik B 10433007 për paditësen.”

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 87 të Ligjit të Punës e lidhur me nenin 329 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet procedurale e ka marrë konform nenit 450 të LPK-së ndërsa për vendosjen jashtë seancës ka vendosur konform nenit 399 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimet ankimore të paditëses se e paditura ka paraqitur përgjigjen në padi pas afatit të paraparë ligjor dhe se në rastin konkret janë plotësuar kushtet për tu nxjerrë aktgjykimi në bazë të mosbindjes sipas nenit 150, pika a), b) dhe c) të LPK-së, kjo gjykatë i vlerëson si të paqëndrueshme pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se e paditura aktvendimin për përgjigje në padi e ka marrë me datë 02.02.2023, kjo sipas fletë dërgesës për dorëzim personal ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 08.02.2023.

Po ashtu Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike ngase nuk kanë qenë kontestuese ditët e pranisë së paditëses në punë për të cilën periudhë kohore kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shujtës ngase paditësja M. Gj. ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, përkatësisht është e punësuar në SH.F.M.U “Sh. K.” në fshatin N. e E., Komuna Gjakovë si mësimdhënëse dhe kjo provohet përmes Kontratës së Punës 61/10 dhe për periudhën kohore nga viti 2014 gjer në vitin 2017, e njëjta ka pasur gjithsej 496 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 35/2022, të datës 09.02.2022 të lëshuar nga e paditura SH.F.M.U “Sh. K.” në fshatin N. e E., Komuna Gjakovë dhe e njëjta ka udhëtuar nga vendbanimi i saj për në vendin e punës me biletë udhëtimi 1.00 € në një drejtim

Mirëpo në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aplikuar nenin 87 të Ligjit të Punës dhe drejtë ka vlerësuar pretendimet e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës ngase vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të ushqimit në punë e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ashtu që paditësja padinë e ka parashtruar me datë 24.02.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e ushqimit në punë dhe shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore prej datës 01.01.2015 deri me datë 17.04.2017.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.3632/2023, më datë 25.04.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj